

KOSOVO



AKADEMIA OLIMPIKE E KOSOVËS  
KOMITETI OLIMPIK I KOSOVËS

# FTESË PËR APLIKIM NË ASMC 4

Ju ftojmë që të aplikoni në kursin e avancuar për menaxhimin e Organizatave Sportive, i cili organizohet nga Komiteti Olimpik i Kosovës në bashkëpunim me Komitetin Olimpik Ndërkombëtar. Kursi i avancuar për menaxhimin e organizatave sportive është program i edukimit i cili zhvillohet nga Akademia Olimpike e Kosovës dhe ka për qëllim edukimin dhe ngritjen e kapaciteteve të stafit në Federatat Sportive.



---

## **KURSI I AVANCUAR PËR MENAXHIMIN NË SPORT**

Kursi i avancuar për menaxhimin e organizatave sportive olimpike do të zhvillohet në gjashtë module: Organizimi i një organizate sportive olimpike; Menaxhimi në nivel strategjik; Menaxhimi i burimeve njerëzore; Menaxhimi i financave; Menaxhimi i marketingut dhe organizimi i një ngjarje madhore sportive, si dhe punimi i temës përfundimtare dhe mbrojtja e saj. Ligjërimi do të realizohet në bazë të literaturës dhe praktikave më moderne në sport nga Komiteti Olimpik Ndërkombëtar, dhe do të ligjërohet nga ekspert vendor dhe ndërkombëtarë. ASMC 4 do të filloj nga data 6 dhe 7 maj 2023 dhe do të përfundojë me diplomim në dhjetor 2023 me organizimin e prezantimit të punimit përfundimtar.

- Hapja e thirrjes: 20 prill 2023
- Mbyllja e thirrjes: 30 prill 2023
- Njoftimi për pjesëmarrje: 03 maj 2023
- Moduli i parë: 6-7 maj 2023
- Moduli i dytë: 3-4 qershor 2023
- Moduli i tretë: 8-9 korrik 2023
- Moduli i katërt: 2-3 shtator 2023
- Moduli i pestë: 7-8 tetor 2023
- Moduli i gjashtë: 4-5 nëntor 2023
- DIPLOMIMI: 15 dhjetor 2023

## **KRITERET PËR APLIKIM**

Kandidatët të cilët aplikojnë për kursin e avancuar për menaxhimin e organizatave sportive duhet të kenë, të kryer kursin për administratorët sportive, edukim të lartë profesional, njohjen e gjuhës angleze si dhe njohuri të programeve kompjuterike.

## **AFATI DHE DOKUMENTET PËR APLIKIM**

Koha për aplikim do të jetë dhjetë ditë nga data e shpalljes 20.04.2023 deri më 30.04.2023 në ora 16:00h. Kandidati duhet të paraqesë këto dokumente: CV, letër rekomandimin nga organizata sportive, letërnjoftimin, kopje të diplomës universitare dhe kursit për administrator dhe kurseve tjera.

---

## MATERIALET DHE KRITERET PËR PJESËMARRËSIT E KURSIT

Materialet e pjesëmarrësve përfshijnë literaturën e cila buron nga Libri “ Manxhimi i Organizatave Sportive Olimpike” e botuar në vitin 2020, materialet e secilit modul për mbajtje të shënimeve dhe përgatitja e prezantimeve. Pjesëmarrësit duhet të jenë prezent 100% në ligjërata, për secilin modul duhet të përgatiten rastet e studimit punimi përfundimtarë dhe të plotësohet testi për çdo modul.

## PROCESI I PËRZGJEDHJES

Dokumentet e paraqitura nga kandidatët do të seleksionohen, ata të cilët kanë plotësuar kriteret do të i nënshtrohen intervistimit për të bërë përzgjedhjen e kandidatëve të sukseshëm, për çdo proces kandidatët do të njoftohen nëpërmjet email.



Propozimet të dërgohën në e-mail adresen:

**secretarygeneral@noc-kosovo.org**, më së largu deri  
në datën **30.04.2023** në orën **16:00**